

Data: 14/11/2023

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PROCEDURË E HAPUR MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SISTEMI I SIGURISË PERIMETRALE”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE
TË NDRYSHME -39300000-5.**

VLERA E FONDIT LIMIT: 145,590,452 (Njëqind e dyzet e pesëmilion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) Lek, pa TVSH ose 1,396,551(Njëmilion e treqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH.

***Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14/11/2023 është 104.25
Lekë/Euro***

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”, Në Nenin 82, të LPP “*1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Duke marrë në konsideratë specifikën e mallrave objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet te ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2020, 2021, 2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.*

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, të nenit 41 të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Duke marrë në konsideratë kontratën objekt prokurimi është menduar se vlera e kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar me kontratat e ngjashme të jetë brenda vlerës kufi të përcaktuar në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka sigurinë dhe besueshmërinë që operatori ekonomik ofertues do realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar për pajisjet që do të ofrojë.

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”
- ISO 20000:1 “Sistemi i menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit”

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 20000-1: “Sistemi i Menaxhimit të shërbimit” – Ky standard është i nevojshëm për të specifikuar kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit. Ky sistem mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat përmbushin kërkesat e dakortuara dhe japin vlerë për konsumatorët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbime. Ky standard u jep kompanive mundësinë të demonstrojnë aftësitë profesionale të tyre në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës nga të cilët:

- ✚ Minimumi 4(katër) punonjës të diplomuar në profilet (Elektronik/Telekomunikacion/ Informatikë / Kompjuterik);
- ✚ Minimumi 1(një) inxhinier ndërtimi;
- ✚ Minimumi 1(një) ekspert zjarrfikës të certifikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/ Drejtoria MNZH;
- ✚ Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuara për sistemet e vëzhgimit;
- ✚ Minimumi 2(dy) punonjës të certifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit. (Në lidhje me këtë kriter duhet të paraqesin dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të);
- ✚ Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuara për menaxhimin e kamerave;
- ✚ Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuara për sistemet e alarmit;
- ✚ Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuara për sistemin Ledwall;
- ✚ Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuara për sistemet e aksesit.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Certifikatat e mësipërme të vlefshme;
- ✚ Diploma;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Gusht 2023 – Tetor 2023;

Shënim: AK do të lejoj që 1(një) punonjës të ketë më shumë se një Certifikim.

Argumentimi: Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

- Referuar kriterit të mësipërm për realizimin me sukses dhe brenda afateve është kërkuar prezenca në stafin e operatorit ekonomik e një numri minimal prej 15 të punësuarisht duke marrë në konsideratë nevojën për inxhinierë të specializuar për drejtimin e proceseve komplekse që përfshijnë punimet për instalimin (f.v) të kamerave, alarmeve, akseseve, etj. Integrimin e të gjithë

rrjetit në një sallë të vetme monitorimi të qëndërzuar etj dhe nevojën për të realizuar e sukses të gjithë kontratën brenda afatit.

-Për të garantuar eksperiencën e stafit të operatorit ekonomik pasi kemi të bëjmë me një procedurë që për nga vlera dhe kompleksiteti janë shumë të rëndësishme është kërkuar prezenca në stafin e operatorit ekonomik për të paktën 3-muaj që është dhe periudha minimale e parashikuar në Kodin e Punës si periudhë prove për një punonjës.

Konkretisht:

- Minimumi 4 (katër) punonjës të diplomuar në profilet (Elektronik/Telekomunikacion/Informatikë / Kompjuterik);

Në mënyrë që të zgjerojë konkurrencën dhe për të moslimituar operatorët ekonomik, AK ka kërkuar 4 inxhinierë të cilët mund të jenë të profileve ekuivalente elektronik /telekomunikacion/informatik/kompjuterik. Referuar aftësive dhe kompetencave që këta persona zotërojnë sipas profesionit do të angazhohen drejtpërdrejtë në mbikqyrjen dhe drejtimin e proceseve të instalimit të sistemeve të sigurisë në 3 sitet (Vau i Dejës, Magazina e Kesh sh.a Durrës, Zyra qëndrore Tiranë) dhe gjithashtu do të asistojnë AK gjatë periudhës së mirëmbajtjes.

- Minimumi 1(një) inxhinier ndërtimi;

Duke qenë se do të zhvillohen punime për instalimin e sistemeve të sigurisë në infrastrukturë kritike siç është diga, ky person do të mbikqyrë zbatimin e punimeve, rregullave të sigurisë në punë, kthimin e kantierit në gjendjen e mëparshme pas përfundimit të punimeve etj.

- Minimumi 1(një) ekspert zjarrfikës të certifikuar nga Ministria e Punëve të Brendshme/ Drejtoria MNZH;

Prezenca në staf e ekspertit zjarrfikës garanton AK se operatori ekonomik gëzon kompetencat e duhura profesionale për tju përgjigjur çdo lloj incidenti që mund të ndodhë me infrastrukturën ekzistuese, gjithashtu planet e punës do të hartohen duke patur në konsideratë rregullat për mbrojtjen nga zjarri.

- Minimumi 2 (dy) punonjës të certifikuar nga prodhues / institucione të autorizuar për sistemet e vëzhgimit.

Këta do të jenë personat që do të realizojnë instalimet e kamerave në pikat e caktuara nga AK. Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjeve brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktet që do të montojnë.

- Minimumi 2(dy) punonjës të certifikuar për sigurinë teknike në punë ndaj elektricitetit. (Në lidhje me këtë kriter duhet të paraqesin dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të).

Kjo kërkesë për kualifikimin e nevojshëm profesionale është në përputhje me Nenin 40, pika 5/c, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Natyra e projektit

përfshin një volum të konsiderueshëm shërbimesh instalimi dhe konfigurimi, realizimi me sukses dhe profesionalizëm i të cilave kërkon prezencën e punonjësve të kualifikuar për sigurim teknik.

-Minimumi 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuar për menaxhimin e kamerave.

Këta do të jenë personat që do të realizojnë konfigurimet e pajisjeve sipas specifikimeve të kërkuara dhe do bëjnë integrimet e nevojshme me sallën e monitorimit. Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e programit të menaxhimit të pajisjeve të sigurisë.

-Minimumi 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuar për sistemet e alarmit.

Punonjësit e mësipërm janë të nevojshëm për realizimin e instalimeve të sistemeve të alarmit/emergjencave në pikat e caktuara nga AK. Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjeve brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktet që do të montojnë.

-Minimumi 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuar për sistemin Ledwall.

Punonjësit e mësipërm janë të nevojshëm për realizimin e instalimeve të Ledwall në sallën qendrore të monitorimit. Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjeve brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktet që do të montojnë.

-Minimumi 2 (dy) punonjës të çertifikuar nga prodhues/ institucione të autorizuar për sistemet e aksesit.

Punonjësit e mësipërm janë të nevojshëm për realizimin e instalimeve të sistemeve të aksesit në pikat e caktuara nga AK. Trajnimi/Certifikimi nga prodhuesi është garanci për AK se këta persona janë të aftë dhe kanë eksperiencën e nevojshme për të realizuar instalimin e pajisjeve brenda afatit të realizimit të kontratës pasi kanë marrë të gjithë njohuritë e nevojshme për produktet që do të montojnë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve, të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët ku përcaktohen specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi, me të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. Katalogët duhet të jenë të verifikueshëm në website të tyre përkatës.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë se mallrat objekt prokurimi janë të reja dhe të pa përdorura.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me anë të këtyre deklaratave AK krijon bindjen se operatori ekonomik do të përmbush kontratën bazuar në specifikimet dhe kërkesat teknike të kërkuara nga AK, duke garantuar furnizmin me mallra të reja.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, sipas parashikimeve të nenit 36 të Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Specifikimet teknike janë përgatitur referuar studimit mbi menaxhimin dhe kontrollin e sigurisë së digave

Njësia e Prokurimit